



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 471/3 prot.

Tiranë, më 31.07.2018

**V E N D I M**

Nr.74, Datë 31.07.2018

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË NJËSINË E VETËQEVERISJES VENDORE, BASHKIA PEQINDHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E LIGJSHMËRISË.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Peqin,

**VËREJ SE:**

Me vendimin nr. 215, datë 25.10.2017, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Gramsh dhe Bashkinë Peqin”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin, Bashkia Peqin.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e

administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 1730 prot., datë 25.10.2017, të miratuar nga Komisioneri i cili me shkresën nr. 1730/1 prot., datë 25.10.2017, “Njoftim në lidhje me mbikëqyrjen në Bashkinë Peqin”, i është njoftuar këtij institucioni.

Bashkia përfshihet si subjekt i mbikëqyrjes së Komisionerit, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pasi, në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 471 prot., datë 25.05.2018, të Komisionerit, “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Peqin, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, duke i lënë një afat 15 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me materialin, nëpërmjet shkresës nr. 550 prot., datë 11.06.2018, “Dërgohet relacioni për problemet e ngritura në projekt-raportin e paraqitur nga grupi mbikëqyrës i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, institucioni është shprehur se problemet e ngritura në projektraport qëndrojnë dhe këto vërejtje do t’i shërbejnë njëkohësisht për të rregulluar situatën e shërbimit civil të ardhmen.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## V E N D O S A:

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Peqin dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Kryetari i Bashkisë Peqin, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit dhe të rregullojë pasojat, duke ndërprerë marrëdhëniet financiare me institucionin për punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, të cilët janë evidentuar në vijim sipas emrit, pozicionit të punës dhe aktit të emërimit:
  1. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Specialist TIK*”, emëruar me urdhrin nr. 22, datë 29.3.2016, të Kryetarit të Bashkisë Peqin.
  2. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Inspektor i Apelit Tatimor*”, emëruar me urdhrin nr. 25, datë 17.2.2017, të Kryetarit të Bashkisë Peqin.
  3. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Shef i sektorit të studimi, të projektimit dhe përputhshmërisë ligjore*”, emëruar me urdhrin nr. 16, datë 4.3.2016, të Kryetarit të Bashkisë Peqin.
  4. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Shef i sektorit të politikave të shërbimeve publike dhe monitorimit të territorit*”, emëruar me urdhrin nr. 15, datë 4.3.2016, të Kryetarit të Bashkisë Peqin.
  5. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Specialist Inxhinier, Gjeodez*”, emëruar me urdhrin nr. 10, datë 24.2.2016, të Kryetarit të Bashkisë Peqin.
  6. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Përgjegjëse e Sektorit të Planifikimit të Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile*”, emëruar me urdhrin nr. 14, datë 3.3.2016, të Kryetarit të Bashkisë Peqin.
  7. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Inspektore e Ndhmës Ekonomike dhe PAK*”, Njësia Administrative Shezë, emëruar me urdhrin nr. 6, datë 3.2.2016, të Kryetarit të Bashkisë Peqin.

8. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Inspektore e Ndhmës Ekonomike dhe PAK*”, Njësia Administrative Karinë, emëruar me urdhrin nr. 43, datë 31.8.2015, të Kryetarit të Bashkisë Peqin.
9. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Inspektor i Ndhmës Ekonomike dhe PAK*”, Njësia Administrative Gjoçaj, emëruar me urdhrin nr. 123, datë 6.6.2017, të Kryetarit të Bashkisë Peqin.
10. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Inspektor i Ndhmës Ekonomike dhe PAK*”, Njësia Administrative Pajovë, emëruar me urdhrin nr. 76, datë 21.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Peqin.
11. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Inspektor i Ndhmës Ekonomike dhe PAK*”, Njësia Administrative Përparim, emëruar me urdhrin nr. 72, datë 30.9.2015, të Kryetarit të Bashkisë Peqin.
12. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Specialiste Punonjëse Sociale*”, emëruar me urdhrin nr. 155, datë 3.10.2016, të Kryetarit të Bashkisë Peqin.
13. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Specialist Psikologe*”, emëruar me urdhrin nr. 13, datë 3.3.2016, të Kryetarit të Bashkisë Peqin.
14. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Specialiste Strehimi*”, emëruar me urdhrin nr. 22, datë 29.3.2016, të Kryetarit të Bashkisë Peqin.
15. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Specialiste për Arkiv/Protokollin*”, emëruar me urdhrin nr. 89, datë 14.4.2016, të Kryetarit të Bashkisë Peqin.
16. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Specialist i Mirëmbajtjes së Rrjetit Kompjuterik*”, emëruar me urdhrin nr. 68, datë 28.3.2017, të Kryetarit të Bashkisë Peqin.
17. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Specialist për Ndjekjen e Debitorëve*”, emëruar me urdhrin nr. 44, datë 15.3.2017, të Kryetarit të Bashkisë Peqin.
18. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore*”, emëruar me urdhrin nr. 59, datë 3.3.2016, të Kryetarit të Bashkisë Peqin.
19. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Specialist i Taksave dhe Tarifave vendore*”, emëruar me urdhrin nr. 47, datë 15.2.2016, të Kryetarit të Bashkisë Peqin.

- Me qëllim që të mos pengohet veprimtaria normale e institucionit, Njësia përgjegjëse, të planifikojë ecurinë e kësaj procedure, duke alternuar veprimin e Kryetarit të Bashkisë për konstatimin si akte absolutisht të pavlefshme, të rasteve të evidentuara më sipër, me procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, sipas neneve 22, 23, e vijues, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore përkatëse dhe procesi i rregullimit të ligjshmërisë të ndahet në dy faza.
  - Dokumenti i planit tëveprimit në këtë rast do t’i paraqitet për miratim Komisionerit, brenda afatit të paralajmërimit dhe më tej do të ndiqet zbatimi i tij nga Sekretariati i Komisionerit, sipas afateve të vendosura në këtë akt.
3. Kryetari i Bashkisë Peqin, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të urdhrin nr. 23, datë 2.5.2014, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit”, pasi ky emërim është realizuar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, Njësia Përgjegjëse, fillimisht të nxjerrë aktin e përfundimit të marrëdhënies së punës për punonjësën \*\*\*\*\*, “Specialist në sektorin e Shërbimeve dhe Investimeve”, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, sepse kjo punonjëse nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të vendit të punës.

Më tej, të përfundojë procedurën e nisur më parë për plotësimin e këtij pozicioni pune, duke zbatuar aktin nr. 21 prot., datë 21.05.2015, për emërimin e nëpunësës \*\*\*\*\*, “Specialist në sektorin e Shërbimeve dhe Investimeve”, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit. Periudha e provës për këtë nëpunëse do të fillojë në momentin që ajo do të ushtrojë efektivisht detyrën në pozicionin e punës ku ajo është emëruar pas konkurrimit.

4. Njësia Përgjegjëse, referuar nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikës 6, të Kreu III, të Vendimit nr. 116, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktual që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të nxjerrë aktin e përfundimit të marrëdhënies së punësimit për punonjësit të cilët nuk i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të vendit të punës e konkretisht:

1. \*\*\*\*\* , emëruar nëpërmjet urdhrin nr. 67, datë 01.10.2008, në pozicionin e punës “Inspektore buxheti”, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme pasi ka arsim të mesëm.

2. \*\*\*\*\*, emëruar nëpërmjet urdhrin nr. 28, datë 1.5.2008, në pozicionin e punës “*Inspektore finance*”, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme pasi ka arsim të mesëm.
  3. \*\*\*\*\*, emëruar nëpërmjet urdhrin nr. 2, datë 03.01.2008, në pozicionin e punës “*specialiste*”, në Drejtorinë e Planifikimit Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme pasi ka arsim të mesëm.
  4. \*\*\*\*\*, emëruar nëpërmjet urdhrin nr. 2, datë 03.01.2008, në pozicionin e punës “*specialiste e taksave dhe tarifave vendore*”, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave, nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme pasi ka arsim të mesëm.
  5. \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 54, datë 15.10.2008, në pozicionin e punës “*Përgjegjës sektori i planifikimit të emergjencave dhe mbrojtjes civile*” në Drejtorinë e Planifikimit Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, nuk i plotëson kriteret e posaçme, pasi ai zotëron diplomën e arsimit të lartë në nivelin “Bachelor”, ndërkohë që pozicioni i punës kërkon diplomë në nivelin “Master profesional”.
- Njësia Përgjegjëse e institucionit duhet të fillojë sa më parë punën për plotësimin e këtyre pozicioneve nëpërmjet procedurave të konkurrimit, duke i shpallur si të lira këto pozicione, si dhe duke u kujdesur të përmbushë rregullat e përcaktuara në Kreun IV, “*Pranimi në shërbim civil*”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*” dhe Vendimin nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese*”.
5. Njësia përgjegjëse, të shfuqizojë urdhrin nr. 17, datë 24.3.2014, për emërimin në detyrë të nëpunësit \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist i taksave dhe tarifave vendore*”, sepse përzgjedhja e këtij kandidati për konkurrimështë bërë në kundërshtim me ligjin. Punonjësini momentin e seleksionimit paraprak, kishte përfunduar studimet në nivelin “*Bachelor*” (*diploma e datës 16.06.2012*), ndërkohë që, nisur nga kërkesat e posaçme të përcaktuara edhe në aktin e publikimit, ky pozicion punë kërkonte që kandidati të zotëronte një diplomë të nivelit “*Master Profesional*”, apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në shkencat ekonomike dhe juridike. Të vijojë procesi i rekrutimit duke filluar me shpalljen si të lirë të pozicionit të punës, për t’u plotësuar më pas në përputhje me procedurat që kërkojnë aktet ligjore dhe nënligjore për shërbimin civil.

6. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *”Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, të ndryshuar dhe në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe të mbahen parasysh gjatë procesit të miratimit të strukturës përfundimtare të institucionit për vitin 2018, për të zbatuar detyrimin ligjor të respektimit të skemës së funksionimit të shërbimit civil, parashikuar në nenin 19, të ligjit për nëpunësin civil. Një kopje e përshkrimeve të punës, të depozitohet në arkivin e institucionit.

Njësia Përgjegjëse të njoftojë të gjithë aktorët e procesit të hartimit të formularit të përshkrimit të punës për detyrat e lëna nga Komisioneri, pasi pas përfundimit të afatit paralajmërues, në rast të mos kryerjes së detyrave përgjegjësia do të jetë individuale për njësinë që nuk ka zbatuar ligjin.

7. Njësia përgjegjëse, duhet të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2017 dhe në vijim, për vitin 2018, të ndjekë procesin për të respektuar afatet, duke orientuar edhe aktorët e tjerë të procesit, ndër të cilët eprorët e drejtpërdrejtë, sipas drejtimeve të përcaktuara në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes. Vlerësimi i nëpunësve të realizohet në përputhje të Vendimin nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar, duke plotësuar të gjitha rubrikat e formularëve dhe në përfundim të çdo faze të nënshkruhetky akt nga të gjithë zyrtarët (raportues, kundërfirmues dhe autorizues).

Njësia Përgjegjëse të njoftojë të gjithë aktorët e procesit të hartimit të formularit të vlerësimit të punës për detyrat e lëna nga Komisioneri, pasi pas përfundimit të afatit paralajmërues, në rast të mos kryerjes së detyrave, përgjegjësia do të jetë individuale për njësinë që nuk ka zbatuar ligjin.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, formulari i vlerësimit për çdo nëpunës civil të përfshihet në Regjistrin Qendror të Personelit.

8. Njësia përgjegjëse e institucionit, të zbatojë me përpikmëri planin vjetor për pranimin në shërbimin civil për vitin 2018 e në vijim, duke filluar procedurat ligjore për plotësimin e të gjitha vendeve të lira të punësmejëherë pas miratimit të planin vjetor nga titullari i institucionit.

9. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **3 muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
10. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Peqin, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, si dhe të paraqesin të gjitha aktet administrative që vërtetojnë masat e marra.
11. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Peqin dhe Njësia Përgjegjëse , duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë dhe Ministria e Brendshme.
12. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**